

**VENDIM**  
**Nr. 136, datë 21.5.2026**

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 14.2.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘EB ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 168/4 prot., datë 19.5.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘EB Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “EB Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 14.2.2025, i ndryshuar me vendimet nr. 268, datë 27.10.2025 dhe nr. 14, datë 15.1.2026, vendosi të licencojë shoqërinë “EB Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar, me kushtet përkatëse.

- Në referencë të pikës 3 të vendimit, shoqëria duhej të fillonte operimin brenda datës 15.2.2026, ndërsa në referencë të pikës 4, ajo duhet të dokumentonte në ERE testimin e veprës jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën nr. 168/1 prot., datë 22.1.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje dhe i ka sjellë në vëmendje dhe plotësimin e kushteve të mbetura.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 459 prot., datë 3.2.2026, shoqëria ka bërë me dije se ka nisur operimin e centralit.

- Me shkresën nr. 168/2 prot., datë 27.3.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë informacionin/ dokumentacionin përkatës në kuadër të plotësimit të të gjitha kushteve të vendimit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 168/3 prot., datë 2.4.2026, shoqëria ka njoftuar se ka filluar operimin e centralit brenda datës 15.2.2026, sikurse raportuar dhe me shkresën e sipërcituar, si dhe ka depozituar akt-kolaudimin tekniko-ekonomik të centralit.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Rezulton se shoqëria ka filluar operimin brenda datës 15.2.2026 dhe ka dokumentuar në ERE testimin e veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 40/2025, të ndryshuar. Si e tillë, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të vendimit nr. 40/2025, ndaj vlerësohet që këto pika të shfuqizohen.

- Në vijim të shfuqizimit të pikave 3 dhe 4, të vendimit nr. 40/2025, të ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 5, si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi kompetent.

- Në kushtet kur pikat 3 dhe 4, të vendimit nr. 40/2025, të ndryshuar, janë përmbushur, vlerësohet se duhet të shfuqizohen.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, të ndryshuar, si vijon:

- a) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, të ndryshuar, shfuqizohet;
- b) Pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, të ndryshuar, shfuqizohet;
- c) Pika 5, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, të ndryshuar, bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EB Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**